Duke marre për bazë që kërkesat për uji janë të larta për aq sa rrënjët mbesin si një top. Pasi rrënjët fillojnë të shtrihen përtej topit të rrënjëve, drunjte do të kërkojë më shumë kujdes dhe në raste të caktuara do të aplikojmë edhe ujitjen në mbrëmje. Po ashtu do ta konsiderojmë edhe sigurimin e ujitjes shtesë si jetike në mbjelljet eventuale të reja, në qoftë së natyra nuk ofron shirat të rregullt. Gjatë motit të nxehtë,bari dhe drunj të rinj do te ujiten tri herë në javë për të siguruar që rrënjët në forme topi të mos thahen.

Meçe toka nuk është mirë të jetë e lagur për periudha të gjata, sepse uji zhvendos ajrin në tokë, kështu që në periudha të gjata të ngopjes së tokës mund të ju merret frymëmarrja rrënjëve në rritje. Nivelin e ujitjes në një mase do ta menaxhojmë përmes praktikumit të mulqimit sidomos në pjesët ku kërkohet ri—gjenerimi i parkut më druje të rinj.

Mulqimi mbron drunjte gjatë prerjes së barit si edhe shmangë paraqitjen e barërave të këqija. Mulqimi në fakt është një shtresë prej materiali që mbulon sipërfaqen e tokës rreth bimë.

Për me tepër mulqimi si praktikë e re, është një lloji moderatori i tokës, rregullon temperaturat, nxit zhvillimin e rrënjëve, pasi qe rrënjët preferojnë të jenë të freskëta në verë dhe të ngrohtë në dimër. Gjithashtu, ruan lagështin duke zvogëluar avullimin e ujit nga sipërfaqja e tokës, redukton problemet sëmundjes dhe mban frutat të pastra përmes shmangies se kontakti tokë-fruta dhe eliminon konkurrencën për ujë duke reduktuar përmes shmangies se kontakti tokë-fruta dhe eliminon konkurrencën për ujë duke reduktuar barërat e këqija.

Foto: Mulqimi (rrethimi dhe mbulimi i sipërfaqeve të drunjve)



Fig 2. Mulching around plants is an excellent way to conserve soil moisture and encourage vigorous plant growth

Sa shpesh duhet aplikuar ujitjen dhe sa ujë për një ujitje varet nga lloji i drunjve, barit, vetitë fizike të tokës së, dhe gjendjen klimatike - sidomos reshjet, lagështia, temperatura, dhe lëvizja e erës. Për të mos lejuar qe bimët(bari, drunjte) të ballafaqohen më stresin e ujit, është e dëshirueshme të mbahen intervalet midis ujitjeve për aq kohë sa të jetë e mundur. Për tu

siguruar se do të kemi një zhvillim uniform te drunjve dhe barit, dhe për te eliminuar diferencat në zhvillim do të kujdesemi me masa té veçanta si me poshtë:

Ujitja selektive - Sasia e ujitjes do te aplikohet edhe në mënyrë selektive, drunjte me rrënje te dëmtuara, meçe mund të kenë nevojë të ujitjes shtesë deri sa rrënjët e reja të rriten për të zëvendësuar ato që janë shkatërruar.

Koha e vitit – Sasia për një ujitje dhe frekuenca e ujitjes do të bazohet edhe në kohen/stinët e vitit. Ujitja do te jete me intensive duke filluar nga mesi i deri të fund të verës, kur temperaturat janë më te larta dhe lagështia e ruajtur në tokë gjatë dimrit varfërohet.

Moti - Në vitet e thatësirës, lagështia e tokës shpenzohet deri në fillim të sezonit, kështu që periudha e ujitjes është më e gjatë. Disa drunj që normalisht nuk kanë nevojë për ujitje do të mund të përfitojnë nga ujitje në vitet e thatësirës. Në vitet e shumë të lagësht, ujitja nuk do mund të jetë e nevojshme deri në verën e hershme ose më vonë.

Foto: Shpeshtësia e ujitjes dhe sasia për një ujitje arrin qershor dhe korrik (Jul)




Përveç mënyrës së aplikimit të ujitjes, sasisë së ujit për ujitje dhe shpeshtësisë si elemente tjetër do te konsiderohet edhe koha e ujitjes. Për te aplikuar efikasitetin e ujitjes do të kujdesemi qe ujitja të praktikohet në orët e mëngjesit prej 4 deri 8 meçe eliminon humbjen e ujit nga avullimi për shkak të temperaturave të ulëta dhe më pak prezence te rrezeve te diellit. Gjithashtu, shpejtësitë e erës janë zakonisht më të ulëta se ato do të jenë më vonë gjatë ditës qe ndikon ne shperndarjen e ujit.

Për të siguruar së qytetaret të cilët frekuentojnë parkun do të kenë në dispozicion parkun gjatë ditës, ujitja në mesdite nuk do të praktikohet edhe pse në disa raste është e mirëseardhur për bimët sepse ule temperaturën në siperfaqet e ujitura. Për të plotësuar nevojat e ujitjes në disa raste do të aplikohet ujitja e barit në orët e vonshme të mbrëmjes për të freskuar parkun pa ndikuar në qasjen e qytetarëve në park.

Ujitja e thelle 12 deri 13 cm lejon lagështi të depërtojnë në zonën e tokës ku rrënjët lehtësisht mund të thithin atë dhe mban lagështi për disa ditë, ndërsa një lagësht vetëm 2.50 cm kështu që është e thatë brenda një dite

Gjithashtu, shumë ujë në një tokë shkakton mangësi oksigjen, duke rezultuar në demtimin e sistemit rrënjë. Rrënjët e bimëve nevojë për oksigjen për të jetuar. Kur a tokës mbetet oksigjen lagur pak është i pranishëm në tokë. Kur ekziston ky kusht rrënjët.

## 2.2 Krasitja e drunjve dekorative dhe prerja e barit

Në kuadër të mirëmbajtjes së parkut të qytetit, si aktivitet shumë i rëndësishëm, pas ujitjes d te jete krasitja e drunjve, luleve, pemëve. Gjithashtu, edhe pse nuk është planifikuar ne procesin e tenderimit, prerja e barit si aktivitet është po aq i rëndësishëm sa edhe ujitja. Gjate stinëve pranvere dhe vere prerja e barit do të praktikohet minimumi një herë në javë.

Foto: prerja e barit



Krasitja e drunjve, luleve, pemëve do të jetë aktivitet i rëndësishëm, sidomos në fazën e krijimit të kurorës në formën standarde dhe eventualisht, mund të krijohen forma të figurave të ndryshme përmes artit të krasitjes. Krasitja dhe prerja e barit do të kenë efekt direkt në aspektin mbajtjes së formës, gjatësisë, trashësisë dhe kualitetit si dhe estetiken e tapetës së barit.

Krasitja praktikohet edhe në eliminimin e pjesëve të vdekura në mungesë ushqimi, ajri apo dielli, duke pas kujdes së krasitja e r krasitja e rende ul nivelet që stimulon rritjen e rrënjës krasitja e rënd ul nivelet që stimulojnë rritjen e rrënjës.

Krasitja si aktivitet kërkon shkathtësi profesionale dhe për këtë arsye do të trajnohet stafi i cili do te ushtroje ketë aktivitet për të eliminuar mundësin e intervenimeve të gabueshme në aspektin e formës apo intervenimet jashtë sezonit që mund të kenë si pasoj jetëgjatësinë e drunjve.

Krasitja do të praktikohet më mjete moderne dhe të mirëmbajtura për të eliminuar infektimet eventuale me viruse të ndryshëm. Me tutje, pjesët të cilat do të konsiderohen të prekura rende

nga ndonjë dëmtues pa mundësi ri-parimi do të eliminohen për të evituar mundësin e bartjes së sëmundjeve dhe pjesët e hequra do të trajtohen sipas rregullave standarde. Mjetet te cilat përdoren përfshin uniformen dhe pajisjet.

Fotot më poshtë ilustrojnë praktikat e krasitjes:krasitja në lartësi që kërkon mjete përkatëse, krasitja e ulet dhe krasitja estetike.



2.3 Mbjellja, regjenerimi barit dhe drunjve dekorative

Në procesin e mirëmbajtjes së parkut si aktivitet i radhës krahas ujitjes dhe krasitjes do të praktikohet procesi i rigjenerimit apo ri mbjelljes së drunjve dhe barit. Ri-gjenerimi mund të jetë i pjesshëm dhe i plote. Në faza të ndryshme të ciklit të jetës së drunjve dhe barit përfshire edhe kohëzgjatjen e jetës së tyre mund të vije deri të dëmtimi i pjesshëm apo i plote.

Intervenimet do të jenë përkatëse, intervenimi pjesshëm në sipërfaqe të barit apo drunjve të dëmtuar duke trajtuar barin në mënyre të veçante më ujitje dhe ushqim më minerale të caktuara. Gjithashtu edhe të drunjte do të intervenohet njëjte, por ne raste caktuara krahas këtyre masave do të praktikohet edhe krasitja e dhunshme e pjesës së dëmtuar për të tentuar të shpëtohet druri. Gjithsesi me i komplikuar është rasti ri-gjenerimit të pjesshëm të sipërfaqeve të barit, derisa të drunjte intervenimit lehta nuk marrin shumë kohë dhe mjete.

Procesi i ri-gjenerimit të plotë të bari nënkupton zëvendësimin e pjesshëm të barit të dëmtuar apo ri përsëritje të procedurës së mbjelljes. Gjithashtu, të drunjte nëse nuk japin efekte intervenimet e pjesshme do të praktikohet zëvendësimi i drurit të dëmtuar me drurin e ri duke ruajtur strukturën ekzistuese.

Në rastet më ekstreme kur tërë sipërfaqja e barit apo tapeta e barit pëson ndryshime nga dëmtimet si pasoj e faktorëve të ndryshme, kujdesit jo adekuat apo kohës së jetëgjatësisë atëherë do të intervenohet me procesin e ri mbjelljes se plotë të barit në tërë sipërfaqen ekzistuese

Situata, ndryshon të drunjte, meçe jetëgjatësia e masës së drunjve ndryshon nga bari dhe intervenimet e ndara janë lehtë të aplikueshme. Në rastet e te gjitha formave të ri gjenerimit ne marrim përgjegjësin për implementim e këtij aktiviteti me qellim të ruajtjes se funksionalitetit te parkut gjatë gjithë kohës se implementimit te projektit.

Në vijim shiheni fotot e ri gjenerimit të pjesshme të barit dhe drunjve



Kujdesi- Si masë për të parandaluar dëmtimin e barit apo drunjve do të praktikojmë trajtimin adekuat me insekticid, herbicide apo fungicide sipas rastit. Në rastet e paraqitjes së sëmundjeve eventuale do te bëjmë trajtimin adekuat më medikamente të rekomanduara për luftimin e dëmtuesve.

2.4 Pastrimin nga mbeturinat/menaxhimi i mbeturinave te parkut

Në mënyre që parku të jetë funksional dhe atraktive krahas aktiviteteve të përmendura vend të rëndësishëm zënë edhe ruajtja e pastërtisë së parkut apo menaxhimi mjedisor i parkut. Ne fakt, ky aktivitet lidhet më menaxhimin e mbeturinave. Meqenëse është një pjesë shumë e frekuentuar e qytetit të Skenderajt, në bazë të projektit planifikojmë vendosjen e ulëseve per nje

komditet me te mire te frekuentuesve. Në mes të hapësirës së gjelbër, sipas këtij projekti është planifikuar edhe një fontantë e ujit. "

Foto: Pushimi i rehatshëm në ulëse praktike në shoqëri dhe ndaras





Menaxhimin e mbeturinave do ta organizojmë dhe praktikojmë në partneritet më qytetaret. Sapo ta jete parku i gatshëm për të pritur vizitore, pushues do ta organizojmë një mbrëmje me qytetaret, si takim sensibilizues për ruajtjen e mjedisit. Për më tepër në hyrje të parkut dhe në disa vende brenda parkut do të vendosim shenja që tregojnë për kujdesin ndaj ambientit si "Ruajeni Mjedisin", "Parku ju përket qytetareve", "Pastërtia është shëndeti" . Do të kujdesemi për vendosjen e shportave në vende të në mënyre që frekuentuesit e parkut ti hedhin mbeturinat e lehta të krijuera nga ushqimi dhe pijet.

Foto: Shporta për hedhjen e mbeturinave te lehta afër ulëseve



www.shutterstock.com · 104028241

Gjithashtu, në partneritet më komunën dhe komunitetin do të përcaktojmë vendin e kontejnerëve për të mos afektuar pastërtinë parkut dhe shportave për hedhje të mbeturinave.

Foto: Pastrimi i parkut



Një element më rendësi do të jetë përcaktimi i kohës së pastrimit të parkut, këtu mendojmë për pastrimet e lehta gjatë ditës pa ndikuar në rehatinë e frekuentuesve dhe pastrimin gjeneral ne orët e vonshme të mbrëmjes apo herët në mëngjes. Njëkohësisht, në këtë park përveç uleseve dhe shportave do të rregullohet edhe ndriçimi përmes paneleve solar.

Fotot: ndriçimit solar



Si masë shtesë që ndikon në implementimin e projektit kemi menduar edhe sigurimin e ndriçimit të parkut me energji solar. Ndriçimi i parkut do të ketë efekte shumëdimensionale, parku në mbrëmje do të ketë një pamje vizuale shumë tërheqëse dhe të rrisë sigurinë e frekuentuesve të parkut dhe rrethinës së parkut në orët e vona te mbrëmjes. Si rezultat do të rrisë frekuentimin edhe gjatë orëve të mbrëmjes kur mikroklima do të jetë ideale për ecje dhe aktivitet tjera rekreative.

2.5 Punësimi (krijimi i vendeve të reja të punës – Rëndësia e parkut kalon përtej efektit mjedisor dhe social, adreson edhe sfidën kryesore në shoqërinë tonë apo papunësinë. Përmes këtij projekti në mënyre direkt dhe indirekte do të gjenerohen së paku 13 vende të reja të punës. Të punësuarit do të kalojnë fillimisht fazën e trajnimit për të menaxhuar parkun. Në kuadër të menaxhimit do të trajnohen në përfitimin e shkathtësive dhe njohurive në kodin e sjelljes më qytetaret të cilët frekuentojnë parkun, përfitimin e shkalhtësive praktike dhe teorike lidhur më ujitjen, krasitjen, pastrimin dhe manipulimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Parku i qytetit do të jetë një reference më tepër për komunën e Skenderajt për aplikimin e partneritetit publiko-privat në menaxhimin e pasurisë publike si dhe do të nxisë hapjen e objekteve hoteliere dhe dyqaneve për ofrimin e shërbimeve për qytetaret të cilët do të frekuentojnë parkun.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Nr. 1-464-33350
Data 12.06.2015

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Nr. 1-464-33350 Prot

Skenderaj, me 12.06.2015

KOMUNA SKENDERAJ

Në kuadër të autorizimeve ligjore, përkatësisht; nenit 14, nenin 58, pika a),b),d),g),i) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në përputhje me nenin 6, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenet: 11,12,13,14,15,16,17,dhe 18 të Kapitullit III të Regullorës së QRK-së Nr.23/2013 për Percaktimin e Procedurave të Dhenies në Shfrytezim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimit të Kuvendit të Komunës; 01Nr.464-26059. dt.30.04.2015 Komisioni Vlerësues bën këtë:

## SHPALLJE PUBLIKE
për
<u>dhënjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatë shkurtër, pesëmbdhjetë (15) vite</u>

### LËNDA E ANKANDIT PUBLIK

Lëndë e ankandit publik është toka e pandertuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt, e paraparë me Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Rregullativ të qytetit të Skenderajt, miratuar nga Kuvendi i Komunës me Vendimin 01Nr. 350-73 të datës 07.10.2011, me dedikim për ndertimin e objekteve me destinim afarizëm - hoteleri,(sipas krietereve ndertuese të percaktuara nga DUMA), në emer të kompenzimit ofrimi i mirëmbajtjës për parkun e qytetit "Idriz Rreci", depoziti për pjesëmarrje në ankand publik dhe kona e mbajtjes së ankandit publik.

1. *Ndërtimi i lokalit afarist hotelier në:*
   - *Parcelën kadastrale nr.586/0, Certifikata me nr.5325, dt.14.042015*
   - *Me siperfaqe të tërësishme prej 0.31.80 ha*

Gabim teknik në nr. e parcelës ku duhet të jetë sipas Vendimit të K.K. i Nr. 1-464-26059 dt. 30.04.15 Parcela kadastrale nr. 562/0

10.07.2015

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJ • REPUBLIC OF KOSOVO • MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

## TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Te drejtë për pjesëmarrje në ankand kanë:

- Personat fizik, shtetas te Republikës se Kosovës, shtetas të vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe të OECD, si dhe shtetas të vendeve që nuk janë anëtarë të Unionit Evropian dhe të OECD-së, me kusht që në reciprocitet të theksojnë pronësinë e tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Kosovës,
- Personat juridik: person juridik i vendit, person juridik në pronësi të përzier dhe personi juridik i themeluar nga person i huaj fizik dhe juridik, të regjistruar në regjistrin përkatës te Republikës së Kosovës, persona juridik të huaj rezidentë të vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe të OECD-së, me kusht që në reciprocitet të theksojnë pronësinë e tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Kosovë

## KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKAND PUBLIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, (në formë të shkruar, <u>në zarf te posaçëm për parcelë ndërtimore)</u> të kompletuar me dëshmitë në vijim:

1. Fletëparaqitje nga dorëzuesi, në të cilën janë shkruar të dhëna për dorëzuesin e fletëparaqitjes, të dhëna për tokën ndërtimore për të cilën dedikohet fletëparaqitja dhe çfarë dokumentacioni dorëzohet si shtojcë;
2. Dëshmi për depozitë te paguar në origjinal (të theksohet numri i shpalljes dhe numri rendor i parcelës ndërtimore në qëllimin);
3. Për personat fizik certifikatë të nënshtetësisë
4. Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik në regjistrin përkatës;
5. Fotokopje të llogarisë personale transaktive.

Fletëparaqitjet që nuk janë të kompletuara me këto dëshmi, nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
Dorëzuesit e fletëparaqitjeve është e nevojshme që të dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, dhe fotokopje nga llogaria personale transaktive, në të cilën do të mund të kthehet depoziti për pjesëmarrje në ankandin publik.

## KRITERET VLERSUESE

Kriter vlersues në ankandin publik për parcelen ndertimore të sipërtheksuara në emer të shfrytëzimit të pronës publike komunale është:

a). Projekt ideja me e mirë mbi ofrimin e sherbimeve për mirmbajtjen e parkut "Idriz Rreci", në të cilen perfshihet: ujitja, krasitja, mbjellja dhe regjenerimi i barit, pastertija nga mbeturinat etj....

b). Numri i të punësuarve në këtë projekt partnerteti?

## DEPOZITI

1. Depoziti për pjesëmarrje ne ankandin publik është: - *2.000.00 €,(dy mijë euro)*

2. Depoziti paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK, në Buxhetin e Komunës së Skenderajt, llogaria transaktive 1000650280000075, kodi 50417 – programi i urbanizmit me shenjen "depozitë për ankand publik për marrjen në shfrytëzim të tokës ndërtimore " (të theksohet numri rendor i lokacionit me dedikimin e përcaktuar dhe numri i parcelës ndërtimore);
3. Depoziti ju kthehet në tërësi dorëzuesve te fletëparaqitjeve për ankandin publik në afat prej 15 ditësh, nga dita e mbajtjes së ankandit publik, përveç ofertues fituese depoziti i të cilëve do të llogaritet si pjesë e shpenzimeve administrative.
4.

## AFATET

Ankandi publik është i hapur **30 (tridhjetë)** ditë nga dita e shpalljes së Ankandit .

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje mund te dorëzohen në adresë të Komuna e Skenderajt, 41000, Rr." 28 Nentori ", pn. Skenderaj, apo drejtpërdrejt në arkivin e Komunës – objekti i administratës zyra nr.1.

Ankandi publik do të mbahet në sallën e mbledhjeve në objektin e Komunës së Skenderajt, me 13.07.2015, e Hene duke filluar në ora 10.00

## PROCEDURA

1. Ankandi publik mund të filloje me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik,.
2. Ankandin publik e përcjell Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës.
3. Ankandi publik fillon me komunikimin e kritereve të ofruara nga ofertat e hapura, ndërsa realizohet me ankand publik nga pjesëmarrësit.
4. Ankandi kryhet "hap pas hapi" me rritjen e vlerës se ofertave për ofrim të sherbimeve me çdo "hap", por edhe duke vlersuar cilësinë e tyre.

5. Ankandi publik llogaritet i mbyllur në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, por nëse pas kalimit të dy minutave të fundit jepet ofertë nga pjesëmarrësit, atëherë afati i fundit per përfundim të ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta. Vazhdimi i afatit përfundimtar lejohet më së shumti tre herë gjatë ankandit publik.
6. Pjesëmarrësi në ankand publik që ka ofruar sherbime si në cilësi ashtu edhe në sasi më të lartë theksohet me statusin ofertues më i volitshëm.
7. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përgatit procesverbal për ankandin publik të realizuar dhe i rekomandon Kryetarit.
8. Kryetari i Komunës në bazë të rekomandimit të komisionit të vlerësimit nënshkruan marrëveshje me ofertuesin më të volitshem për dhënjën në shfrytëzim për 15 vite të tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Skenderajt. Me marrëveshjen ofertuesi më i volitshem detyrohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të të njëjtit, ta dorezojë atë te noteri apo në gjykatë për solemnizim dhe në afat prej 2 muajve nga solemnizimi i kryer i marrëveshjes, të sigurojë leje për ndërtim të objektit të paraparë në përputhje me palnin urbanistik sipas të cilit toka është dhënë në shfrytëzim, në të kundërtën marrëveshja do të ndërpritet dhe pagesat nuk do t'i kthehen bleresit. Me marrëveshjen ofertuesi më i volitshëm detyrohet që ta ndërtojë objektin sipas planit urbanistik dhe kritereve te percaktuara nga DUMA sipas të cilit është dhën në shfrytëzim toka në <u>afat jo më të gjatë se 2 vjet nga dita e marrjes së lejes për ndërtim</u>.
9. Evidentimin dhe bartjen e të drejtave të shfrytëzimit të patundshmërive në librat e tokës dhe kadastrës i bartë Komuna.
10. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të dorëzojnë kundërshtim te Komisioni për ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik . Pas kundërshtimit me aktvendim Komisioni është i detyruar që të vendosë në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Komisioni Vlersues :

1.kryesues
2.Antar
3.Antar
4. Antar
5. Antar
6. Antar
7. Antar

Kjo shpallje do të publikohet në dy gjuhët zyrtare:

- ueb faqen zyrtare të Komunë së Skenderajt: www. Skenderaj-gov.net
- një gazetë të përditshme
- tabelën e shpalljeve publike të Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr./No. 1-464-33355
Data/Date 12.06.2015

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Br. 1-464-33355

Skenderaj, dt. 12.06.2015 g.

OPŠTINA SKENDERAJ

Na osnovu zakonskih ovlašćenja, odnosno člana 14, člana 58, tačka a),b),d),g),i), Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, i su skladu sa članom 6,7 i 8 Zakona br.04/L-144 za Davaje na Korišćenje Opštinske Nepokretne Impovine, kao i čalnovi: 11,12,13,14,15,16,17 i 18 Poglavlje III Pravilnika VRK br. 23/2013, za određivanje postupaka za davanje na korišćenje i razmenu Nepokretne Opštinske Imovinee kao i odluke gradonačelnika 02br.464-26059 od dana 30.04.2015, Komisija za procenjivanje objavlja sledeći:

## OGLAS

Za davanje na korišćenje opštinske nepokretne kratkorčno korišćenje, za petnaest(15)godina

## PREDMET JAVNE LICITACIJE

Predmet javne licitacije je neizgrađeno zemljište u vlasništvi opštine Skenderaj, koja je previđeno Razvojnim Urbanskim Planom i Regulatvnim Planom grada Skenderaj, usvajanom od Skupštine Opštine Odlukom 01br. 350-73 od dana 07.10.2011, gde je planirano izgradnja poslovno-stambenih objekata ( po kriterima za izgradnju određene od DUZP) u ime kompenzacija za održavanje zeleništa "Idriz RReci", depozit za učestvovanje u ankandu i vreme održavanja javnog ankanda.

1. Izgradnja Poslovno Prostorija u
   - Kadastrralnoj Parceli br. 586/0 sa br. 5325, dt. 14.04.2015 g.
   - Sa celom površinom od 0.31 ha.

8. Predsednik Opštine, na osnovu preporuke komisije potpisaće ugovor sa najpovoljnijim ponuđačem koji je dužan da u roku od 30 dana od dana potpisivanja ista da predaje [illegible] kopije [illegible] na Sudu [illegible] u roku od [illegible] meseca posle overe ugovora je dužan da pribavi dozvolu za izgradnju predviđenog objekta [illegible] sa [illegible] planom na kojem je [illegible] Korisnik isto dodatno je dužan da u roku od 2 godine da izgradi objekat od dana dobijanja dozvole za izgradnju.
9. Evidentiranje i prenos prava na korišćenje nepokretne imovine u knjigama za zemljište i Katastar preuzima opština.
10. Nezadovoljni ponuđači sa javnom licitacijom mogu podneti žalbu u roku od [illegible] dana od dana objavljivanja javnog oglasa. Posle žalbe preko rešenja Komisija je dužna da odluči o tom pitanju u roku od 5 dana od dana prijema žalbe nezadovoljnog.

11. Ovaj oglas će se objavljivati na dva službena jezika:
- Veb strani opštine Skenderaj www.Skenderaj-gov.net
- Na dve dnevne novine
- Na tabli za javne oglase opštine Skenderaj

Komisija za Procenjivanje:

1. Presedavajući ____________
2. Član ____________
3. Član ____________
4. Član ____________
5. Član ____________
6. Član ____________
7. Član ____________

[illegible]

[illegible]

[illegible] ... sertifikat [illegible]

## USLOVI UČESTVOVANJA NA JAVNOJ LICITACIJI

[illegible]

1. [illegible]
2. [illegible]
3. [illegible]
4. [illegible]
5. Fotokopije transaktivnog ličnog žiroračuna.

Aplikacije koja nisu kompletirane pomenutim dokazima, neće se razmatrati.

Predavači aplikacija trebaju predati aplikaciju za učestvovanje na javnik ankand, fotokopiju transaktivnog ličnog žiroračuna na kojem bih se mogao vratiti depozit za učestvovanje na javnoj licitaciji.

## KRITERI PROCENJIVANJA

Kao kriter koji se proceni u javnoj licitaciji za građevinsku parcelu, gore navedene u ime korisnika javne opštinske imovine je kao sledeće.

a) Najbolja nacrt-idea za pružanje usluge za održavanje zeleništa "Idriz Rreci" na kojem se obuhvaćat navodnjavanje, košenje, sejanje i regenracija trave, higijena i otpatke.
b) Broj zaposlenih na ovom projektu?

## DEPOZIT

1. Depozit za učestvovanje na javnoj licitaciji je 2.000,00 (dvehiljade) €.
2. Depozit se mora uplatiti u licenciranim bankama od CBK u korist budžeta Republike Kosova transaktivni žiroračun 1000500228000 [illegible] kod 50417 – program urbanizma sa oznakom "depozit za podvrgavanje na korišćenje građevinskog zemljišta" i da postavi redni broj, oklopa i destinacija kao i broj građevinske parcele.
3. Depozit će se vratiti u celosti predavaćima aplikacija za javni ankand u roku od 15 dana od dana održavanja javnog ankanda, osim onom koji je dobio javni ankand, koji novac će se poračunati kao deo administrativnih troškova.

## ROKOVI

Javna licitacija će biti otvorena 30 (trideset) dana, od dana objavljivanja licitacija.
Prijavljivanja za učestvovanje se mogu predavati u sledeću adresu "Opština Skenderaj 41.000 [illegible] (28 novembar)" [illegible] Skenderaj [illegible], [illegible] u arhivu opštine – objekat Administracija – kancelarija br. 1.
Javni Ankand će održavati u Sali za održavanja sastanaka u objektu Opštine Skenderaj, datum 13.07.2015 godine, ponedeljak, sa početkom u 10.00 časova.

## POSTUPAK

1. Javna licitacija može početi sa najmanje jednog učesnika u licitaciji, za svaku građevinsku parcelu posebno.
2. Red u javnoj licitaciji će platiti komisija izabrana od Skupštine Opštine.
3. Javna licitacija objavljivanjem kriterijume za otvorena ponuda, a realizuje se javnim ankandom od strane učesnika.
4. Licitacija se završi "korak po korak" povećanjem vrednosti svaki "korak" [illegible] u vrednost.
5. Javna licitacija se smatra zatvorenom prilikom isteka određenog vremena za prog[illegible] ili ako posle isteka dva zadnja minuta daje se ponuda od učesnika, tada zadnji rok oglasa se produžuje za dva minuta, produžetak zadnjeg roka glasa dozvoljava se najviše tri puta u toku javne licitacije.
6. Učesnici u javnoj licitaciji koji su ponudili najvišu ponudu određuje se najviši ponuđački status – dobitnik.
7. Komisija posle završetka javne licitacije priprema zapisnik za realizovanu javnu licitaciju.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr. 1-464 - 33355
Data 12.06.2015

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Nr.1-464-33355 Prot

Skenderaj, me 12.06.2015

## KOMUNA SKENDERAJ

Në kuadër të autorizimeve ligjore, përkatësisht; nenit 14. nenin 58. pika a).b),d).g),i) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në përputhje me nenin 6, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenet; 11,12,13,14,15,16,17,dhe 18 të Kapitullit III të Regullorës së QRK-së Nr.23/2013 për Percaktimin e Procedurave të Dhenies në Shfrytezim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimit të Kuvendit të Komunës; 01Nr.464-26059. dt.30.04.2015 Komisioni Vlerësues bën këtë:

## SHPALLJE PUBLIKE
për
<u>dhënjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatë shkurtër, pesëmbdhjetë (15) vite</u>

### LËNDA E ANKANDIT PUBLIK

Lëndë e ankandit publik është toka e pandërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt, e paraparë me Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Rregullativ të qytetit të Skenderajt, miratuar nga Kuvendi i Komunës me Vendimin 01Nr. 350-73 të datës 07.10.2011, me dedikim për ndërtimin e objekteve me destinim afarizëm - hoteleri,(sipas krietereve ndertuese të percaktuara nga DUMA), në emer të kompenzimit çmimi i mirembajtjës për parkun e qytetit "Idriz Rreci", depoziti për pjesëmarrje në ankand publik dhe koha e mbajtjes së ankandit publik.

1. ***Ndërtimi i lokalit afarist hotelier në;***
   - *Parcelën kadastrale nr.586/0, Certifikata me nr.5325, dt.14.042015*
   - *Me siperfaqe të terësishme prej 0.31.80 ha*

## TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Te drejtë për pjesëmarrje në ankand kanë:

- Personat fizik, shtetas te Republikës se Kosovës, shtetas të vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe të OECD, si dhe shtetas të vendeve që nuk janë anëtarë të Unionit Evropian dhe të OECD-së, me kusht që në reciprocitel të theksojnë pronësinë e tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Kosovës,
- Personat juridik: person juridik i vendit, person juridik në pronësi të përzier dhe personi juridik i themeluar nga person i huaj fizik dhe juridik, të regjistruar në regjistrin përkatës te Republikës së Kosovës, persona juridik të huaj rezidentë të vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe të OECD-së, me kusht që në reciprocitet të theksojnë pronësinë e tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Kosove

## KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKAND PUBLIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, (në formë të shkruar, në zarf te posaçëm për parcelë ndërtimore) të kompletuar me dëshmitë në vijim:

1. Fletëparaqitje nga dorëzuesi, në të cilën janë shkruar të dhëna për dorëzuesin e fletëparaqitjes, të dhëna për tokën ndërtimore për të cilën dedikohet fletëparaqitja dhe çfarë dokumentacioni dorëzohet si shtojcë;
2. Dëshmi për depozitë te paguar në origjinal (të theksohet numri i shpalljes dhe numri rendor i parcelës ndërtimore në qëllimin);
3. Për personat fizik certifikatë të nënshtetësisë
4. Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik në regjistrin përkatës;
5. Fotokopje të llogarisë personale transaktive.

Fletëparaqitjet që nuk janë të kompletuara me këto dëshmi, nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
Dorëzuesit e fletëparaqitjeve është e nevojshme që të dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, dhe fotokopje nga llogaria personale transaktive, në të cilën do të mund të kthehet depoziti për pjesëmarrje në ankandin publik.

## KRITERET VLERSUESE

Kriter vlersues në ankandin publik për parcelen ndërtimore të sipërtheksuara në emer të shfrytëzimit të pronës publike komunale është:

a). Projekt ideja me e mirë mbi ofrimin e sherbimeve për mirmbajtjen e parkut "Idriz Rreci", në të cilen perfshihet: ujitja, krasitja, mbjellja dhe regjenerimi i barit, pastertija nga mbeturinat etj....

b). Numri i të punësuarve në këtë projekt partneriteti?

## DEPOZITI

1. Depoziti për pjesëmarrje ne ankandin publik është: - *2.000.00 €,(dy mijë euro)*
2. Depoziti paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK, në Buxhetin e Komunës së Skenderajt, llogaria transaktive 1000650280000075, kodi 50417 – programi i urbanizmit me shenjen "depozitë për ankand publik për marrjen në shfrytëzim të tokës ndërtimore " (të theksohet numri rendor i lokacionit me dedikimin e përcaktuar dhe numri i parcelës ndërtimore);
3. Depoziti ju kthehet në tërësi dorëzuesve te fletëparaqitjeve për ankandin publik në afat prej 15 ditësh, nga dita e mbajtjes së ankandit publik, përveç ofertues fituese depoziti i të cilëve do të llogaritet si pjesë e shpenzimeve administrative.
4.

## AFATET

Ankandi publik është i hapur **30 (tridhjetë) ditë nga dita e shpalljes së Ankandit .**

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje mund te dorëzohen në adresë të Komuna e Skenderajt, 41000, Rr." 28 Nentori ", pn. Skenderaj, apo drejtpërdrejt në arkivin e Komunës – objekti i administratës zyra nr.1.

Ankandi publik do të mbahet në sallën e mbledhjeve në objektin e Komunës së Skenderajt, **me 13.07.2015, e Hene duke filluar në ora 10.00**

## PROCEDURA

1. Ankandi publik mund të filloje me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik..
2. Ankandin publik e përcjell Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës.
3. Ankandi publik fillon me komunikimin e kritereve të ofruara nga ofertat e hapura, ndërsa realizohet me ankand publik nga pjesëmarrësit.
4. Ankandi kryhet "hap pas hapi" me rritjen e vlerës se ofertave per ofrim të sherbimeve me çdo "hap", por edhe duke vlersuar cilësinë e tyre.

5. Ankandi publik llogaritet i mbyllur në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, por nëse pas kalimit të dy minutave të fundit jepet ofertë nga pjesëmarrësit, atëherë afati i fundit për përfundim të ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta. Vazhdimi i afatit përfundimtar lejohet më së shumti tre herë gjatë ankandit publik.
6. Pjesëmarrësi në ankand publik që ka ofruar sherbime si në cilësi ashtu edhe në sasi më të lartë theksohet me statusin ofertues më i volitshëm.
7. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përgatit procesverbal për ankandin publik të realizuar dhe i rekomandon Kryetarit.
8. Kryetari i Komunës në bazë të rekomandimit të komisionit të vlerësimit nënshkruan marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm për dhënjën në shfrytëzim për 15 vite të tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Skenderajt. Me marrëveshjen ofertuesi më i volitshëm detyrohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të të njëjtit, ta dorëzojë atë te noteri apo në gjykatë për solemnizim dhe në afat prej 2 muajve nga solemnizimi i kryer i marrëveshjes, të sigurojë leje për ndërtim të objektit të paraparë në përputhje me palnin urbanistik sipas të cilit toka është dhënë në shfrytëzim, në të kundërtën marrëveshja do të ndërpritet dhe pagesat nuk do t'i kthehen bleresit. Me marrëveshjen ofertuesi më i volitshëm detyrohet që ta ndërtojë objektin sipas planit urbanistik dhe kritereve te percaktuara nga DUMA sipas të cilit është dhën në shfrytëzim toka në afat jo më të gjatë se 2 vjet nga dita e marrjes së lejes për ndërtim.
9. Evidentimin dhe bartjen e të drejtave të shfrytëzimit të patundshmërive në librat e tokës dhe kadastrës i bartë Komuna.
10. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të dorëzojnë kundërshtim te Komisioni për ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik . Pas kundërshtimit me aktvendim Komisioni është i detyruar që të vendosë në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Kjo shpallje do të publikohet në dy gjuhët zyrtare:

- ueb faqen zyrtare të Komunë së Skenderajt: www. Skenderaj-gov.net
- një gazetë të përditshme
- tabelën e shpalljeve publike të Komunës

Komisioni Vlersues :

1. Kryesues ______
2. Antar ______
3. Antar ______
4. Antar ______
5. Antar ______
6. Antar ______
7. Antar ______

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Nr. L-464 - 33350
Datum 12-06-2015

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Br.L-464-33350

Skenderaj, dt. 12.06.2015 g.

## OPŠTINA SKENDERAJ

Na osnovu zakonskih ovlašćenja, odnosno člana 14, člana 58, tačka a),b),d),g),i), Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, i su skladu sa članom 6,7 i 8 Zakona br.04/L-144 za Davnje na Korišćenje Opštinske Nepokretne Imovine, kao i članovi: 11,12,13,14,15,16,17 i 18 Poglavlje III Pravilnika VRK br. 23/2015, za određivanje postupaka za davanje na korišćenje i razmenu Nepokretne Opštinske Imovinee kao i odluke gradonačelnika 02br.464-26059 od dana 30.04.2015, Komisija za procenjivanje objavlja sledeći:

## OGLAS

Za davanje na korišćenje opštinske nepokretne kratkoročno korišćenje, za petnaest(15)godina

### PREDMET JAVNE LICITACIJE

Predmet javne licitacije je neizgrađeno zemljište u vlasništvi opštine Skenderaj, koja je previđeno Razvojnim Urbanskim Planom i Regulatvnim Planom grada Skenderaj, usvejanom od Skupštine Opštine Odlukom 01br. 350-73 od dana 07.10.2011, gde je planirano izgradnja poslovno-stambenih objekata ( po kriterima za izgradnju određene od DUZP) u ime kompenzacija za održavanje zeleništa "Idriz RReci", depozit za učestvovanje u ankandu i vreme održavanja javnog ankanda.

1. Izgradnja Poslovno Prostorija u
   - Kadastralnoj Parceli br. 586/0 sa br. 5225. dt. 14.04.2015 g.
   - Sa celom površinom od 0,31 ha.

### PRAVO NA UČESTVOVANJE

Prava za učestvovanje na licitaciji su sledeći:

- Fizičko Lica državljanin Republike Kosova, državljani država članica Evropske Unije i OECD-a, kao i državljani država koja nisu članica Evropske Unije i OECD-a, pod uslovom da poseduju građevinsko zemljište na teritoriji Republike Kosova.
- Pravno Lice: Domaće pravno lice, pravno lice sa pomešanim vlasništvom i pravna lica osnivan od inostranog fizičkog i pravnog lica, koji je registrovan na dotičnom registru Republike Kosova, inostrani pravnih lica koji dolaze sa država Evropske Unije i OECD-a, pod uslovom da u reciprocitetu da dokaže vlasništvo građevinskog zemljišta na teritoriji Republike Kosova.

### USLOVI UČESTVOVANJA NA JAVNOJ LICITACIJI

Zainteresovana fizička i pravna lica moraju predati zahtev za učestvovanje na Javnoj licitaciji (na pisanom načinu za svaku građevinsku parcela odvojeno, na kojom će pojasniti za koju parcelu je podneta aplikacija, koja dokumentacija je položena aplikaciji, i koja dokumentacija mora biti pakovana na posebnu kovertu za svaku građevinsku parcelu)

1. Aplikacija od predavača, gde su zapisan sve potrebni podaci za predavača aplikacije, podataka o građevinskom zemljištu za koju je predata aplikacija i dokumentacija se predaje kao prilog :
2. Originalan dokaz za uplatu depozita (da se zapisuje broj objave i redni broj građevinske parcele i sl.)
3. Za Fizička Lica treba državljanstvo;
4. Za pravna lica, broj registracije pravnog lica sa dotičnom organu;
5. [illegible]

Vjosa Ahmetaj

| | |
|---|---|
| From: | Vjosa Ahmetaj |
| Sent: | 12 August 2020 13:28 |
| To: | Fatbardha Haliti |
| Cc: | Xhevat Tafa; Muje Selmani |
| Subject: | Kërkesë për material shtesë.... |

E nderuar,

Ju lutem për të vlerësuar ligjshmërinë e Vendimit 01-464/01-0030361/20 për anulimin e Vendimit nr. 1-464-26059, i datës 30.04.2015 dhe Kontratës nr. 2-464-44367, e datës 12.08.2015, na duhen dokumente shtesë ashtu siç përcaktohet me paragrafët 2 dhe 4 të nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës:

> 2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore ti paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.
>
> 4. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit.

Andaj ju lutem që në afat ashtu siç përcaktohet me Rregulloren (QRK) NR.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave të na siguroni dokumentet e kërkuara.

Me respekt!
Vjosa Ahmetaj

Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MPL
Tel: +381 (0) 200 35 662
+383 44 473 336
E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net

Vjosa Ahmetaj

| | |
|---|---|
| From: | Muje Selmani |
| Sent: | 17 August 2020 15:27 |
| To: | Vjosa Ahmetaj |
| Cc: | Bekim H.Jashari; Leutrim Sahiti |
| Subject: | Material shtese |
| Attachments: | Material shtese per vendimin per anulim..pdf |

E nderuar,

Në lidhje me kërkesën tuaj, për material shtesë në lidhje me vendimin e Kuvendit Komunal, me nr. 01-464/01-0030361/20, të datës 03.08.2020, japim sqarimet e nevojshme si në vijim:

Kontrata me numër 2-464-44367, e datës 12.08.2015, mbi dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale në Skenderaj, në afat prej 15 vitesh, është nënshkruar sipas vendimit të Kuvendit Komunal, me nr. 1-464-26059, të datës 30.04.2015, përmes procedurave të Ankandit Publik, sipas së cilit ishte dhënë në shfrytëzim prona, me numër të ngastrës 568/0 ZK - Skenderaj, me sipërfaqe 0.31.80 ha, me qëllim të mirëmbajtjes së parkut "Idriz Rreci" në Skenderaj.

Obligimet e operatorit ekonomik me të cilin është nënshkruar atë kohë kontrata, janë të specifikuara në kontratën si dhe në vendimin për anulim të saj nga Kuvendi Komunal.

Vendimi për Anulim i Kuvendit Komunal është marrë pasi që operatori ekonomik nuk i është përmbajtur obligimeve të parapara me kontratë.

Marrë parasysh këtë, si komunë dhe qeverisje e re, kemi marrë shumë ankesa nga banorët dhe asamblistët për mos mirëmbajtje të parkut nga operatori ekonomik dhe për këtë drejtoria për Gjeodezi ka filluar procedurat për t'i propozuar Kuvendit anulimin e vendimit dhe kontratës në fjalë.
Si Komunë po ashtu sqarojmë që në kohen kur është lidhur kontrata dhe deri në vitin e kaluar ka qenë në fuqi ligj i vjetër dhe nuk është kërkuar raportimi, kurse me miratimin e ligjit të ri në vitin 2019 që kërkon raportimin në fjalë, Kryetari Jashari nuk ka mundur të jap raport 6 mujor të implementimit për një kontratë që vet nuk e ka nënshkruar dhe për të cilat në kohen kur është miratuar ligji i ri veçse kishin filluar ankesat e banorëve e të asamblistëve, dhe si rezultat i kësaj edhe procedurat për anulim të vendimit dhe kontratës në fjalë.
Po ashtu ju sqarojmë që për kontratën në fjalë, pas hulumtimit që ka bërë komuna jonë, gjegjësisht drejtoria dhe drejtori i ri i Gjeodezisë, vitin e kaluar, ka gjetur parregullsi dhe mos përmbajtje të kontratës, andaj edhe kanë filluar procedurat për anulim.

Të bashkangjitur keni procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, në të cilat takime janë shprehur ankesat ndaj kësaj kontrate nga të zgjedhur e qytetarëve të Komunës sonë.

Me respekt:

Jui.dip.Mujë Selmani

Zyrtare i lartë Profesional për punët e kuvendit.
Komuna-Skenderaj.
Centrex: 038 42 720
Mob: 044/399-032, 049/238 163
e-mail: Muje.Selmani@rks-gov.net
muje.selmani@hotmail.com

01-060/01-0056677/19
06.09.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI I MBËLEDHJES KOMITETI PER POLITIK E FINANCAT I MBAJTUR MË DATËN: 23.07.2019,

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385 të datës 03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Kryesuesja e Kuvendit pasi konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e kësaj mbledhjeje të KPF-se Skenderajt, propozon këtë:

RENDDITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara;
4. Propozim vendimin për plotësim-ndryshimin e anëtarit nga radha e ekzekutivit me nr.02-020/01-0043141/19, i dt.11.07.2019, të komisionit për emërimin edhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike brenda territorit administrativ të Komunës së Skenderajt të miratuar në Kuvendin Komunal me vendimin nr.01-020/04-0026002/18, i dt.03.05.2018, (Raporton Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari).
5. Propozim vendim me nr.09-312/01-0043154/19, i dt.11.07.2019, për miratimin e Planit Komunal i Veprimit për Efiçiencës e Energjisë (PKVE) 2018/2020, (Raporton Koordinatori Naim Geci)
6. Raporti i Auditimit për vitin 2018 nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) dhe plani i Implementimit të Rekomandimeve me nr. 04-052/01-0042877/19, i dt.11.07.2019, (Raporton Drejtori z. Mehmet Berisha);
7. Raporti Financiar i realizimit të buxhetit të Komunës Janar-Qershor 2019, me nr.02-052/01-0042869/19, i dt.11.07.2019 (Raporton Drejtori z. Mehmet Berisha);
8. Propozim-vendimi me nr.11-400/01-0043796/19 e dt.15.07.2019 për librin "FOLKLORIN NE DRENICE" dhe konferenca shkencore për folklorin ne Drenicë. (Raporton Drejtori z. Ramiz Shala)
9. Propozim-vendimi me nr.05-463/01-0043805/19 i dt.15.07.2019 për anulimin e vendimit me nr.01/nr.463-66 të dt.05.08.2011 qe ka të beje me ndërrimin e 0.10,00ha, ngastra nr.241 ZK. Skenderaj, me ngastrën nr.669 ZK. Skenderaj prone e kuvendit të komunës (Raporton Drejtori z. Ramiz Shala).
10. Propozim-vendimi me nr.05-463/01-0043806/16 i dt.15.07.2019 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjate kompanisë për grumbullimin e mbeturinave "UNITETI" dhe kompanisë rajonale të rajonale të ujësjellësit "Mitrovica" njësia ne Skenderaj (Raporton Drejtori z. Ramiz Shala).
11. Propozim-vendimi me nr.05-463/01-0043811/19 i dt.15.07.2019 për shpalljes së zonave me interes publik (Raporton Drejtori z. Ramiz Shala).
12. Të ndryshme.

